



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:152708

Datë: 12.05.2023

Numri i dokumentit: 04318799

PS.nr.36/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari – kryetar i trupit gjykues, Arben Hoti dhe Kujtim Krasniqi – anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale të kësaj gjykate Dafina Ymeri, në lëndën penale ndaj të akuzuarit A K nga Obiliqi, për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga nenin 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096², për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës³, me numër PPS.nr.96/2020 të datës: 04.10.2022, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të shtetit nga PSRK – Naim Abazi, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av.Xhafer Tahiri nga Prishtina, **me datën 15.03.2023**, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 12.05.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A K, nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datën ... në Prishtinë, tani me vendbanim në Obiliq, në rrugën “..”, nr..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion marketing i vetëpunësuar, punon në një fabrikë të rrymës dhe punon orendi të rrymës në firmën “...” në fshatin Mazgit, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK-së), nr.06/L-074, i datës 14.01.2019, i cili ka hyrë në fuqi më 19.04.2019.

² Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, i datës 25.05.2016, i cili ka hyrë në fuqi më 15.06.2016.

³ Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, (Në tekstin e mëtejme PSRK)

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale⁴-së:

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse i pandehuri A K, nga data 25.07.2019 deri me datë 13.04.2021, përmes krijimit të faturave të rreme kishte realizuar të hyra të paligjshme, ndërsa me datë 02.11.2020, në bankën NLB në Prishtinë, kishte shkuar për të tërhequr në para të gatshme (cash) shumën e mjeteve në vlerë prej dyqind e një mijë (201,000.00) Euro nga llogaria me numër ..., në emër të biznesit të tij “Redleads Marketing” SH.P.K, duke e ditur se këto mjete janë gjeneruar nga aktiviteti fiktiv ekonomik, me qëllim që të fsheh ose maskoj natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore. Për të njëjtat mjete monetare me kërkesë të kësaj Prokurorie është lëshuar urdhër ndalues afatgjatë për ngrirje të përkohshme të aseteve sipas Urdhërësës së Gjykatës PPPS.nr..., të datës 03.12.2020.

-Këso dore kishte për të kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga nenin 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

-Të akuzuarit A K, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi **I KTHEHEN** shuma e mjeteve në vlerë prej dyqind e njëmijë (201,000.00) Euro, ashtu që **Shfuqizohet** urdhri ndalues afatgjatë për ngrirjen e përkohshme të aseteve, me numër PPPS.... i datës 03.12.2020, me të cilin janë ndaluar shkëmbimi i pronësisë ose tërheqjes nga llogaria bankare me numër: ... me numër te kartelës bankare ... në NLB Bank Prishtinë.

URDHËROHET NLB Bank Prishtinë, që ti heq të gjitha ndalesat të cilat janë urdhëruar sipas urdhrit të lartpërmendur në këtë llogari bankare, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

⁴Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejme KPP-së), nr.08/L-032, i datës 14.07.2022, i cili ka hyrë në fuqi më 18.04.2023.

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.96/2020 të datës: 04.10.2022, ndaj të akuzuarit A K, për shkak të veprës penale Shpërlarja e parave nga nenin 302 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Pas ngritjes së aktakuzës është caktuar shqyrtimi fillestar i cili është mbajtur me datë 20.10.2022, ashtu që i akuzuari i lartpërmendur nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën është ngarkuar me aktakuzë, me ç'rast gjykata ka marr aktvendim me të cilin ka vendosur që të mos mbahet shqyrtimi i dytë mirëpo ka udhëzuar të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij që në afat prej 30 ditësh nga dita e shqyrtimit fillestar dhe atë deri me datën 19.11.2022 ata mund t'i parashtrojnë kundërshtimet përkitazi me pranueshmërinë e provave në mbështetje të nenit 249 par.1 të KPP-së dhe kërkesat për hedhje të aktakuzës në rast se ekzistojnë arsyet nga neni 250 i KPP-së, po ashtu ka obliguar edhe prokurorin e shtetit që në afat prej 7 ditëve pas kundërshtimeve ndaj provave apo kërkesave për hedhjen e aktakuzës të paraqitura nga i akuzuari apo mbrojtësi i tij, i njëjti të jep përgjigje me shkrim lidhur me kundërshtimet dhe kërkesat e lartpërmendura, në të kundërtën do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e dhënies së përgjigjes lidhur me kundërshtimet ndaj provave dhe hedhjen e aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit A K av.Xhafer Tahiri, pranë kësaj gjykate me datën 07.11.2022 me shkrim ka paraqitur kundërshtim ndaj provave dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Ndërsa me datën 10.11.2022 Prokurori i shtetit nga PSRK, me shkrim ka paraqitur përgjigje lidhur me kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, Kryetari i trupit gjykues, ka marr aktvendimin me numër PS.36/22 të datës 25.11.2022, me të cilin i ka refuzuar si të pabazuara kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës të mbrojtësit të akuzuarit A K, av.Xhafer Tahiri.

Me datën 01.12.2022, mbrojtësi i akuzuarit A K, av.Xhafer Tahiri pranë kësaj gjykate me shkrim ka dorëzuar parashtresën, përmes të cilës e ka njoftuar gjykatën se heqin dorë nga e drejta për

ankesë kundër aktvendimit me të cilin ish-in refuzuar kundërshtimet ndaj provave edhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, në këtë çështje penale ka mbajtur Shqyrtimi gjyqësor⁵, i cili ka filluar më datën 16.02.2023 dhe ka përfunduar me datën 10.03.2023, në të cilin shqyrtim gjyqësor kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit nga PSRK Naim Abazi, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av.Xhafer Tahiri.

Prokurori i shtetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor për veprën penale dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A K, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

2. Fjala përfundimtare e palëve⁶

Prokurori i shtetit i PSRK-së Naim Abazi, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit A K, duke shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor pamëdyshje është vërtetuar se i akuzuari, në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të akuzës ka kryer veprën penale Shpërlarje e parave nga nenin 302 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Gjatë shqyrtimit gjyqësor nga administrimi i provave materiale pa mëdyshje gjendja faktike është vërtetuar, ku mbi bazën e provave të administruara janë vërtetuar elementet e veprës penale dhe atë: pranimi i fondeve përmes krijimit të faturave fiktive, ku pranimi i këtyre parave apo fondeve njihet si faza e parë e vendosjes së parave në sistemin financiar në Kosovë, ashtu që i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete kishte përpiluar dokumente me përmbajtje të rreme (fatura) apo me prezantim tjetër të rremë kishte prezantuar qarkullimin e rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë

⁵ Të gjitha procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 311 par.1 të KPP-së, janë përpiluar me shkrim të cilat procesverbale gjenden në shkresë e lëndës ashtu që shqyrtimi gjyqësor nuk është regjistruar me audio ose video incizim për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve në gjykatë në kohën kur janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor.

⁶ Prokurori i shtetit i PSRK-së Naim Abazi si dhe mbrojtësit e të akuzuarit avokati Xhafer Tahiri, fjalën përfundimtare të tyre trupit gjykues ia kanë dorëzuar edhe në formë të shkruar.

mënyrë ka rezultuar me krijimin e fondeve që në shikim të parë duken të ligjshme, krejt kjo me qëllim të fshehjes ose maskimit të natyrës së vërtetë apo burimit të këtyre parave, ku të njëjtat janë siguruar përmes krijimit të faturave fiktive kinse në emër të shërbimeve të marketingut edhe pse të akuzuarit i mungojnë shkathtësitë dhe njohuritë bazike në këtë fushë, pastaj pasi që në llogarinë e të akuzuarit ishin transferuar paratë, ku këto transferime kanë ndodhur në emër të faturave të rreme si rezultat i veprimeve të akuzuarit A K përmes krijimit të faturave fiktive në emër të bizneseve në Gjermani, më pas ishin përgatitur deklaratat tatimore dhe të njëjtat ishin prezantuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me qëllim që pranimi i këtyre parave të duket i ligjshëm dhe forma e aktivitetit kriminal të merr trajtë të ligjshëm kinse pranimi i parave është bërë në emër të aktivitetit ekonomik, ku këto veprime paraqesin fazën e dytë të shtresimit apo integritit të parave në sistemin bankar dhe faza finale e shpëlarjes së parave që njihet si integrimi ka ndodhur pas dorëzimit të deklaratave tatimore në ATK dhe pagimit të tatimit, kinse në emër të aktivitetit ekonomik. Gjithashtu ka shtuar se është vërtetuar padyshim se paratë janë siguruar me mashtrim, sepse nuk ka mundësi që të njëjtat të jenë siguruar në mënyrë të ligjshme, e kësaj i shtohet edhe fakti se i akuzuari as që ka njohuri se si udhëhiqet një afarizëm ekonomik, e aq më pak njohuri në fushën e teknologjisë informative dhe nuk ka mundësi që i njëjti paratë në fjalë t'i ketë siguruar nga klientët e tij në kuadër ushtrimit të veprimtarisë afariste. Po ashtu ka shtuar se gjykata duhet t'ia fal besimin e plotë deklaratave të dëshmitarëve, ndërsa mbrojtjes së të akuzuarit mos t'ia fal besimin, pasi që mbrojtja e tij është në kundërshtim të thellë me dëshmitë e dëshmitarëve dhe shkresat e tjera në lëndë. Andaj i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, të dënohet sipas ligjit duke marrë parasysh rrethanat rënduese si dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim që përkon me veprën penale për të cilën akuzohet si dhe i njëjti të ngarkohet me pagesën e shpenzimeve të procedurës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A K, av.Xhafer Tahiri, fjalën e tij përfundimtare e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor duke shtuar se PSRK nuk ka arritur të dëshmoj përtej dyshimit të arsyeshëm se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale “Shpërlarja e parave” nga neni 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 56 parag.1. nënpar.1.5 dhe parag.3, nënparagrafi 3.1, të Ligjit Nr.05/L-096, për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, për të cilin e ngarkon aktakuza. Ka shtuar se të gjitha provat në këtë lëndë penale, ashtu siç mbrojtja i paraqiti në shqyrtimin gjyqësor të datës 16.02.2023, dëshmojnë se dy kompanitë Gjermane AV Networks UG, me pronar V Sh dhe EB Media UG me pronar E B, në mënyrë transparente, jo të fshehur, paratë e tyre të fituara ligjshëm në shtetin e Gjermanisë nga aktiviteti i deklaruar, Marketing në internet, i kanë transferuar në

mënyrë të ligjshme në llogari bankare të Redleads Marketing SH.P.K në Kosovë, në bazë të marrëveshjes-kontratës për shërbime marketingu, shërbime që këto kompani i kanë pranuar nga Redleads Marketing SH.P.K dhe faturave përkatëse të përpiluara në bazë të kontratës në mes të palëve. Gjithashtu në këtë çështje penale, PSRK, ka pasur bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e drejtësisë me autoritetet e Prokurorisë Gjermane, përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës. Ndonëse PSRK nuk e ka përshkruar përgjigjen që ka marrë nga autoritetet në Gjermani lidhur me aktivitetin e dy kompanive partnere të Redleads Marketing ShPK, e të cilat janë AV Networks UG, me pronar V Sh dhe E B Media UG, me pronar E B, përkatësisht nëse pasuritë/mjetet financiare të tyre burojnë nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal në Gjermani, mbrojtja kërkon me respekt nga Gjykata që të vlerësoj drejtë edhe veprimin e PSRK-së, e cila me datë 25.08.2022 ka marr Aktvendim për Pushimin e Hetimit, me numër PPS.nr 96/2020, kundër të pandehurve E B, S K, V Sh, për shkak se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se të pandehurit e lartshënuar kishin kryer veprën penale “Shpërlarje e parave”, nga Neni 302 i KPRK-së dhe neni 56 dhe 57 të Ligjit 05/L-096, mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i cili aktvendim vërteton tezën e mbrojtjes se nuk kemi të bëjmë me fshehje të burimit të pasurisë, fshehje të prejardhjes së pasurisë apo përfitim i pasurisë nga ndonjë veprim kriminal në Gjermani, sepse, çdo cent në llogarinë e Redleads Marketing me pronar A K, ka ardhur pikërisht nga xhirollogaritë bankare të 2 kompanive gjermane që udhëhiqen nga V Sh dhe E B. Pra Prokuroria Speciale ka pushuar hetimet, në mungesë provash nga autoritetet Gjermane ose me rekomandim të tyre, ndaj vet personave nga llogaritë bankare të kompanive që ata zotërojnë janë derdhur mjetet financiare në llogarinë e Redleads Marketing SHPK me pronar A K. Gjithashtu ka theksuar se në regjistrat e Qeverisë së Kosovës dhe të autoriteteve Gjermane nuk figuron ndonjë dyshim për aktivitet kriminal të këtyre kompanive mbi bazën e të cilit aktivitet janë përfituar mjete financiare që më pas do të pastroheshin në Kosovë dhe se nuk mund të ketë shpërlarje të parave të këtyre kompanive përderisa këto kompani nuk janë të përfshira në aktivitete kriminale nga të cilat aktivitete kriminale kanë mundur t’i përfitojnë pasurinë/paratë. Po ashtu tani i akuzuari A K nuk kryer ndonjë vepër penale me të cilën ka fituar pasurinë/mjetet financiare, e as personat e tjerë të përfshirë, nuk kanë kryer ndonjë vepër penale nga e cila kanë përfituar pasurinë/mjetet financiare. Gjithashtu edhe nga Marrëveshja-Kontrata për shërbime marketingu në mes të “Redleads Marketing” Sh.P.K dhe dy kompanive gjermane “AV NETWORKS UG”, me seli në Gjermani Reiferbahn 22, 24837, Shlleiswig me pronar V Sh dhe kompania “EB Media UG”, në adresën Moltkestraße 36-38, 24837 Shlleiswig, me pronar E B, të njohura si Insertion Order, e ku me dispozita kontraktuale janë saktësuar qartë obligimet e palëve kontraktuese, e përkthyer në Gjuhën Shqipe dhe nëse kjo marrëveshje në mes të palëve të ishte përkthyer me kohë nga PSRK, që në fazën e hetimit dhe të ishte vlerësuar drejtë si rrethanë në

favor të palës së dyshuar, siç e obligon KPRK, nuk do të kishte fare ngritje të aktakuzës. Por, PSRK, e as ATK dhe as Policia e Kosovës, nuk e kishin përkthyer këtë marrëveshje, kështu duke mos e vlerësuar atë si provë themelore në këtë çështje juridike dhe se nga kjo marrëveshje/kontratë vërtetohet se nuk ka aktivitet kriminal në veprimet e tani të akuzuarit A K, sepse kompania “Readleads Marketing” SHPK me pronar A K si dhe kompanitë Gjermane “AV Networks UG”, me seli në Gjermani Reiferbahn 22, 24837, Shlleiswig me pronar V Shdhe kompania “EB Media UG”, në adresën Moltkestrafte 36-38, 24837 Shleiswig, me pronar E B, kanë kontratë të ligjshme për punë të ligjshme që për objekt të saj e ka marketingun online në internet. Gjithashtu prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj me prova të pa kontestueshme pohimin e saj se kemi të bëjmë me fatura fiktive, se kush i vërtetoi këto fatura fiktive dhe se a kishte ekspertizë profesionale nga ekspertë të pavarur të fushës së financave dhe mashtrimit financiar apo ekspertizë të cilësdo fushë tjetër në të cilën ekspertizë e mbështet PSRK këtë pohim, pra përgjigja është jo. Po ashtu të gjitha transaksionet bankare dëshmojnë se janë raportuar në kohë me faturë në raporte të rregullta në ATK nga i Akuzuari A K si pronar i “Readleads Marketing”, ku është e ditur burimi dhe prejardhja e pasurisë dhe se nuk kemi të bëjmë me transaksione të fshehta financiare dhe as me mjete financiare që nuk ju dihet burimi i tyre; sepse dihet burimi i mjeteve financiare që në këtë rast është Gjermania dhe dihet arsyeja e derdhjes së këtyre mjeteve financiare në xhirollogaritë të Readleads Marketing SH.P.K me pronar tani të akuzuarin A K, e që janë dy kontrata për shërbime marketingu të njohura si Insertion Order. Më tej ka theksuar se vërtetësinë e faturave e rrjedhimisht edhe ligjshmërinë e transaksioneve në bazë të tyre e ka pohuar vetë Dëshmitarja e PSKR-së në shqyrtim gjyqësor të datës 16.02.2023, po ashtu edhe ATK ku sipas Ligjit janë raportuar në kohë të gjitha këto transaksione. Sikur faturat të ishin fiktive, siç pretendon PSRK në aktakuzë, ATK do të lajmëronte në kohë çdo faturë fiktive e të rrejshme si dhe çdo transaksion bazuar në këto fatura të rregullta të pranuar nga ATK, si dhe po të ishin fatura fiktive, ato do të refuzoheshin nga ATK. Për më tepër, memorandum i Informues i ATK-së nuk i kualifikon këto fatura si fiktive sepse përkundrazi i akuzuari A K ka zhvilluar veprimtari të ligjshme ekonomike, bazuar në kontratë të ligjshme për shërbime, për çka ka paguar tatime në ATK bazuar në Ligjet e Republikës së Kosovës siç e dëshmojnë dëshmitë në shkresa të lëndës për pagesën e tatimeve dhe kontributeve. Më tej ka theksuar se dëshmitarja F M – V, në dëshminë e saj në seancën gjyqësore të datës 16.02.2023, dëshmoi se ajo mbanë kontabilitet të 8 kompanive të ndryshme duke e kryer këtë detyrë nga shtëpia e saj e pa pasur nevojë të shkoj në seli të kompanive të cilave ajo ia mbanë kontabilitetin ose të ketë zyre në këto kompani dhe se faturat i ka përgatitë sipas standardeve të njohura ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardeve që i kërkon ATK. Gjithashtu kjo dëshmitare ka theksuar se asnjë faturë, e as faturat që janë pjesë e aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës, nuk janë fiktive sepse nuk

janë refuzuar si të tilla nga ATK. Po ashtu e ka kundërshtuar qëndrimin e prokurorisë se kompania “Readleads Marketing” nuk kishte zyre, pasi që e njëjta ka një seli të regjistruar në ARBK. Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit H G i cili ka theksuar se këto punë mund të kryhen lehtësisht nga shtëpia dhe vetëm me një lap-top e qasje në internet. Ai vërtetoi se kjo punë, pra pastrimi i e-mailave e krijimi i leadsave është punë që mësohet shpejtë, nuk ka nevojë për diplomë a kualifikime ekstra dhe po ashtu dëshmoi se ka kryer punë dhe për këtë ka dorëzuar ne CD edhe në ATK dëshmi të punës që e ka kryer dhe se pretendimi i prokurorisë së ky dëshmitar nuk kishte fakultet të IT të kryer rrjedhimisht nuk din të bëjë këtë punë, është i paqëndrueshëm dhe u dëshmuar e kundërta nga vet dëshmitari i Prokurorisë. Po ashtu ka shtuar se pretendimi i PSRK-së se i akuzuari A K nuk ka fakultet të kryer në fushën e IT, nuk e njeh gjuhën angleze dhe se ka kryer aktivitet fiktiv ekonomik ky pretendim është i pabazuar ku kjo është vërtetuar edhe nga dëshmitari H G i cili ka theksuar se natyra e punës së tillë është që nuk kërkohet as njohja e gjuhës angleze e as njohja e punës me kompjuter e as diplomë universitare. Gjithashtu ka shtuar se aktakuza nuk ka vërtetuar se i akuzuari A K dhe firma “Readleads Marketing” SH.P.K gjatë aktivitetit të tyre ekonomik janë përfshirë në aktivitet kriminal sepse “Readleads Marketing” SH.P.K, me numër biznesi... me pronar A K, e regjistruar sipas Ligjeve të Kosovës, është kompani që aktivitet kryesor të biznesit e ka Agjencitë për Publicitet. Pra “Readleads Marketing” SH.P.K është entitet/kompani e ligjshme me subjektivitet juridik e regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. Më tej ka theksuar se edhe nga Raporti informues i ATK-së, e vërteton faktin se transaksionet janë të njohura, pra dihet nga kanë ardhur paratë, ato kanë ardhur përmes transferit bankar në llogari të “Readleads Marketing” nga një shtet i Bashkimit Evropian – Gjermania dhe ky qarkullim është deklaruar me kohë në ATK dhe për këtë janë paguar tatimet sipas ligjit. Lidhur me pretendimet e Prokurorisë të paraqitura si provë të titulluara Raporti Policor Nr. i referencës 2021-KE-71 nga Policia e Kosovës, DHKEK-DPP Prishtinë, mbrojtja vëren se në raportet e 14 institucioneve financiare të cilat kanë raportuar në bazë të Urdhëresës së Gjykatës PPPS.nr.41/20, 2021-KE-71, në të gjitha këto shkresa nuk vërehen transaksione të dyshimta, transaksione me persona të tjerë brenda apo jashtë Kosovës, aktivitete të financimit të ndonjë veprimtarie ilegale, blerje pronash apo ndonjë aktivitet kriminal i tani të akuzuarit A K në drejtim të veprës penale “Shpërlarje e parave” apo edhe i dy pronarëve të dy bizneseve nga Gjermania. Andaj nga të lartpërmendurat I ka propozuar gjykatës që të vlerësoj drejtë të gjitha faktet e rëndësishme në shkresat e lëndës dhe atë janë tri prova, dokumente të besueshme; hetimi dhe informata nga ILECU si institucion ndërkombëtar me kredibilitet, shënimi Zyrtar 4 i DHKEK dhe memorandum i zyrtar i DHKO, e ku në asnjërin prej tyre provave nuk është zbuluar ndonjë aktivitet kriminal i kompanive “AV Networks UG” nrb HRB 11291FL, i kompanisë tjetër “EB MEDIA UG”, nrb. HRB 13423FL në Gjermani apo

edhe i “Readleads Marketing” SH.P.K në Kosovë. Po ashtu as i akuzuari por as ndonjë i afërm i tij nuk kanë pozita zyrtare, nuk është i përfshirë në aktivitete të korrupsionit, tregtisë me narkotik, tregtisë me armë, kontrabandës me duhan, pije alkoolike, tregtisë me vepra të vjedhura, në tenderë publik, e as në delikte ekonomike apo lojëra të fatit. Gjithashtu edhe nga kontrata e lidhur me datë 01.08.2019, “Readleads Marketing” SH.P.K, Kosovë, me numër biznesi ..., me pronar A K, si Publisher në njërën anë dhe “AV Networks UG,” Gjermani me numër biznesi HRB 11291FL, me pronar V Shpor edhe datë 01.08.2019, “Readleads Marketing” SH.P.K, Kosovë, me numër biznesi ..., me pronar A K, si Publisher në njërën anë dhe “EB Media UG”, Gjermani me numër biznesi HRB ..., me pronar E B, si Advertiser në anën tjetër, ku kanë nënshkruar kontratë për kampanjë reklamimesh në internet e njohur si insertion order , vërtetohet pa asnjë dyshim se tani i akuzuari A K ka zhvilluar një aktivitet ekonomik të ligjshëm. Andaj, gjykata duhet të ja fal besimin deklarimeve të pandehurit, të vlerësoj drejtë provat e paraqitura nga mbrojtja, të vlerësoj drejtë raportet kontraktuale që i akuzuari A K përmes kompanisë së tij “Readleads Marketing” SHPK, kishte me dy kompanitë gjermane “AV Networks UG” dhe “EB Media UG” pasi që PSRK nuk ka arritur me asnjë provë të dëshmojë se A K ka kryer veprën penale nga neni 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 56 parag.1. nënparagrafi 1.5 dhe parag 3, nënparagrafi 3.1, të Ligjit Nr.05/L-096, për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Si dhe i ka propozuar gjykatës që pas analizimit të çështjes në raport me të mbrojturin e tij A K, vlerësimin të fakteve dhe dëshmive të dëshmitarëve, Gjykata të marr Aktgjykim Lirues, të gjitha këto në kuptim të nenit 363 par 1 pika 1.3 të KPPRK-së, si dhe të shfuqizohet Urdhri Ndalue Afatgjatë për Ngrirje të Përkohshme i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special PPPS.nr.41/20, i datës 03.12.2020, kundër të pandehurit A K pronar i Kompanisë Readleads Marketing SH.P.K , me nr. biznesi NUI 811335620.

I pandehuri A K në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari A K, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, gjykata për vërtetimin e gjendjeve faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve dhe administrimin e këtyre provave dhe atë:

- **Dëgjimin e dëshmitarëve:** F M – V dhe H G;

- **Leximin e provave materiale, siç janë:**
- Raportin Policor Informues me shkresa tjera përcjellëse, me numër të referencës DHKEK-421/2020, të datës 04.11.2020 lëshuar nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Raportin Policor - Mbi zbatimin e Urdhëresës së Gjykatës PPPS.nr.41/20, 2021-KE-71, me shkresa të tjera përcjellëse të dhënat bankare nga 14 institucionet financiare dhe 6 CD-ja, me numër të referencës 2021-KE-71, të lëshuar me datën 11.05.2021 nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Faturën me numër: ..., e datës 30.09.2019;
- Faturën me numër: ..., e datës 30.10.2019;
- Faturën me numër: ..., e datës 30.10.2019;
- Faturën me numër: ..., e datës 30.11.2019,
- Faturën me numër: ..0, e datës 30.12.2019,
- Raportin Informues të ATK-së, me numër të referencës /2021, dt.29.10.2021, datën 29.10.2021, lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-së),
- Shkresat e ATK-së, mbi gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve të tjera, Redleads Marketing SH.P.K, me numër fiskal, lëshuar datën 24.05.2021, nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-së).
- Shkresat e ATK-së, me numër të listës 09/2021, lëshuar me datën 19.04.2021, nga ATK;
- Shkresën me titullin Pasqyrë e të ardhurave personale A K, me numër te letërnjoftimit, prej 2012-2021.
- Shkresën e ARBK-së, lidhur me “Redleads Marketing” SH.P.K, për A K, lëshuar me datën 14.04.2021;
- Shkresën e ATK-së, “Redleads Marketing” SH.P.K, me 1 CD, me numër fiskal, lëshuar me datën: 08.09.2021, nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Shkresën e ATK-së, gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera, “Redleads Marketing” SH..K, me nr. fiskal, e dates 12.10.2021, lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Shkresën e NLB Banka, “Redleads Marketing” SH.P.K, periudha kohore 01.01.2019 deri më 20.04.2021, lëshuar me datën 22.04.2021;
- Shkresën e NLB Banka, A K, për periudhën: 01.01.2019 deri më 20.04.2021, lëshuar me datën 22.04.2021;
- Shkresën e Raiffeisen Bank, “Redleads Marketing” SH.P.K, për periudhën 01.01.2019 deri më 24.04.2021, lëshuar me datën 24.04.2021;

- Komunikimi elektronik dhe shkresat tjera, për datat: 27.04.2021 dhe 20.04.2021, nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Shënimin Policor Zyrtar 3, si dhe shkresat përcjellëse, me Nr. reference DHKEK-421/2020, me datën: 09.11.2020, nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Shënimin Policor Zyrtar 4, si dhe shkresat përcjellëse, me Nr. reference DHKEK-P-388/2020, me datën 02.12.2020, nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Shënimin Policor Zyrtar 5, me Nr. reference DHKEK-P-. (421/2020) me datën 02.03.2021, nga Policia e Kosovës DHKEK -DPP Prishtinë;
- Pasqyrat Financiare “Redleads Marketing” SH.P.K, Me datën 31.12.2019;
- Statutin e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, Statuti i “Redleads Marketing” SH.P.K, me datën 24.07.2019;
- Raportin Informues Policor me Nr. reference DHKEK-421/2020, me datën 04.11.2020, Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Shkresën e datës 01.08.2019 - Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Komunikimin elektronik, i datës 22.04.2021, nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Kërkesat për pasqyra – informata për transaksione bankare e ATK-së, me datën 20.04.2021, nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-së);
- Kërkesën për pasqyra – informata për transaksione bankare e ATK-së, me datën 22.04.2021;
- Përgjigjen e MONETA, me nr. ref. P-50/21 lidhur me kërkesën për informata me nr. të ref.148-2020, të lëshuar nga Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, NJP-68/21, dhe 1 CD, me Nr. reference P-50/21, dhe me Nr. të reference148-2020, me data 23.04.2021, 23.04.2021, nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-së);
- Shkresën e Capital, lidhur me kërkesën për informata dhe 1 CD, me Nr. reference 148/2020, me datën 22.04.2021, Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Komunikimet elektronike, me datat; 21.04.2021 dhe 20.04.2021, Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Shkresat e sjella nga ATK dhe 1 CD, e datën 17.05.2022, nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-së);
- Raport Policor për zbatimin e autorizimit numër PPS.nr.96/2020, me nr. ref 589/22 PPS.nr.96/2020, me nr. ref.589/22 PPS.nr.96/2020, me datën 20.06.2022 Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Komunikime elektronike, me datën 12.10.2021 dhe 14.10.2021, Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;

- Komunikimet elektronike, me datat:11.02.2022 dhe 16.03.2022dhe 20.05.2022 Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Komunikime elektronike, me datat:31.01.2022 dhe 11.02.2022 dhe 16.03.2022 Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë;
- Përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me nr.ref.MD/DBGJ/3057/fn/22, DBJN/2021-710, me datën 29.06.2022, Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës;
- Kontratën e datës 01.08.2019, mes dy kompanive “AV Networks UG” dhe “Redleads Marketing”;
- Kontratën e datës 01.08.219, e lidhur ne mes të dy kompanive “ EB Media UG” dhe “Redleads Marketing”;
- Faturat e shërbimit te marketingut ne mes dy kompanive e “AV Networks UG” dhe “Redleads Marketing”;
- Faturat e shërbimit te marketingut ne mes dy kompanive e “EB Media UG” dhe “Redleads Marketing”;
- Shikohet CD me 500 e-mail-a dhe dëshmia me kompanitë për konsulence tatimore;
- Deklarata pajtueshmërisë për kompaninë “Redleads Marketing” e datës 27.07.2020 për pasqyrën financiare që përfundon me datën 31.12.2019;
- I akuzuari A K, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për tu mbrojtur në heshtje, nuk është deklaruar gjatë fazës së mbrojtjes.
- Është lexuar Procesverbali i marrjes në pyetje të akuzuarit A K dhënë në PSRK, datë 11.05.2022;

3.1 Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1 Dëshmitarja–F M V, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar me profesion është kontabiliste dhe në kompaninë “Redleads Marketing SH.P.K ka punuar si kontabiliste dhe për këtë kompani ka njohuri përmes A. Në këtë kompani ka punuar në dhjetor të vitit 2019 deri në përfundimin e aktivitetit të kompanisë dhe se nuk i kujtohet kur është ndal ky aktivitet. Në këtë kompani është paguar me pagë mujore në shumë prej 300 euro dhe kishte punuar prej shtëpisë. Më tej ka theksuar se selia e kësaj kompanie ka qenë në Obiliq dhe pronarët kanë qenë të Obiliqit, mirëpo në seli fizikisht nuk kishte shkuar kurrë dhe përgjegjësi kryesor i biznesit ka qenë A. Ka sqaruar se me A është njoftuar përmes V Sh nga Drenasi me të cilën takohen dhe kanë raporte shoqërore, V me ka tregu që ka pas nevojë firma që ka bashkëpunuar me ta për shërbime kontabiliteti dhe

meqenëse ofroje këtë punë, jam e interesuar për punë kam kontaktuar përmes V me A, pra përmes V jam njoftuar me A ku bashkë me V ka qenë edhe E B. Më tej ka theksuar se këta dy persona jetojnë dhe veprojnë në Gjermani. Ka sqaruar se udhëzimet lidhur me shërbimet e kontabilitetit si kontakt të parë e ka pasur A mirëpo për këto shërbime A dhe V më kanë shpjeguar se çka kanë me faturuar dhe çfarë shërbimi ofron kompania. Për secilën faturë më ka dhënë udhëzime V Sh dhe fatura ka sasi të shërbimit të ndryshëm e përshkrim të njejtë dhe këto shërbime i kam kryer për A, ndërsa A ka kryer shërbime për V Sh dhe se V Sh më ka dhënë udhëzime se çka duhet të mbajë një faturë. Faturat dhe përshkrimi i shërbimit kanë qenë në gjuhën angleze. Nuk e di se A a e njeh gjuhën angleze ndërsa unë gjuhën angleze e njoh jo mjaftueshëm. Përshkrimin e faturave psh. “me emërtimin email shoot payout SOI” ma ka dhënë V, por gjithmonë jam konsultuar me A, me të cilin kam pasur kontakt me telefon dhe i vetmi kontakt fizik që e kam pas kur i kam përgatit dokumentet dhe i kam thënë hajde merri dhe e kam njoftuar për afatet dhe obligimet tatimore ndërsa kontakte fizike tjera nuk kam pasur. Gjithashtu ka shtuar se mban kontabilitet edhe për firma të tjera dhe se këto firma nuk kanë pasur zyre dhe çdo herë kam punuar prej shtëpisë edhe për këto firma, si dhe kur i përgatis faturat për kompanitë tjera prej shtëpisë kontaktin, udhëzimet dhe përshkrimin e punës e merr nga pronari dhe sipas kërkesës së tij formulohet fatura. Më tej ka theksuar se në momentin që faturohet puna, fatura e periudhës që i përket, faturohet në librin e shitjes dhe libri i shitjes deklarohet që i përket në sistemin e rrjetit të ATK-së dhe nuk më ka ndodhur asnjëherë që të ketë refuzim ose kontakt prej ATK-së që nuk është diçka në rregull. Ka sqaruar se sa i përket faturave 2019-04 dhe fatura 2019-05 nuk ka pasur ndonjë parregullsi dhe asnjëra prej faturave nuk më janë kthyer nga ATK. Gjithashtu ka shtuar se ka të kryer nivelin e parë të SKAK dhe ka të kryer fakultetin Ekonomik dhe është në master studente dhe se faturat kur i përgatit i bën në bazë të standardeve vendore dhe kombëtare që kërkohen për kontabilitet dhe faturat që janë në aktakuzë janë të përgatitura sipas atyre standardeve. Poashtu ka shtuar se asnjëherë nuk përgatit fatura të parregullta dhe se nuk më kanë kërkuar A apo V të përgatisë ndonjë faturë të kundërligjshme. Ka shtuar se V Sh nuk është pronar i kompanisë “Readleads Marketing”, ndërsa udhëzimet se çka kam me punë, i kam marr nga A dhe V. Ka theksuar se unë i përpiloj faturat por përgjegjësinë çka ka ne faturë çka shërbehet apo çka prodhohet dhe çka shkon te klienti e merr kompania dhe lëshimin e faturës e punoj unë e dorëzoj te pronari nënshkruhet dhe vuloset dhe vazhdon prej pronarit, kur është shërbim përcjell firma unë e përpiloj si dokument. Në rastin konkret faturat i kam përpiluar vet dhe librat e shitjes i mbaj unë i vendos në file dhe pastaj i dorëzon në firmë dhe kur i duhen për rishikim ose deklaram i merr dhe i dorëzon prapë, si dhe inspektoret e bëjnë inspektimin në firmë. Ka theksuar se e ka pyetur V dhe A lidhur me këtë shërbim dhe i kanë thënë që ofrojnë marketing elektronik për jashtë por më shumë se kam pyet dhe ka vazhduar me përshkrim dhe meqë nuk

është kthyer fatura e ka konsideruar se është në rregull. Si dhe e kam konsideruar si të rregullt se ka punuar prej shtëpisë dhe shërbimi që ka ofruar mund të ofrohet edhe prej shtëpisë pa qene prezent ne firme. Në këto fatura ka të dhënat e firmës kryerjen e shërbimit, sasinë, çmimin etj dhe këtë shërbim e ka pranuar “AV NETWORKS UG”, në Gjermani ku si pronar ka qenë V Sh, pra si kompani kemi bashkëpunuar me dy kompani në Gjermani , emri i kompanisë së firmës së E Bt momentalisht nuk po më kujtohet.

3.1.2 Dëshmitari H G, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ka të përfunduar Komunikim Masiv në Universitetin AAB në vitin 2015, për momentin nuk punon, por si profesion e ka Free Lesing si IT me kompjutera. Më tej ka theksuar se A K n e njuh përmes babait të tij S K. Lidhur me kompaninë “Readleads Marketing” ka theksuar se ka njohuri se pronar është A K ku kishte punuar në këtë kompani në një periudhë të shkurtër diku rreth 5-6 herë kishte shkuar aty dhe si detyrë ka pasur gjenerimin e leads-at dhe për t’i treguar se si bëhen email-at dhe si dërgohen. Gjatë kësaj periudhe sa ka punuar nuk ka pasur kontratë por janë marrë vesh të merr një pagesë në shumë prej 500 euro. Ka theksuar se selia e këtij biznesi ka qenë tek shtëpia e S dhe se ka punuar me kompjuter të S (babait të A). Ka theksuar se për të punuar në free leads nuk duhet me pas diplomë, kjo punë mund të mësohet nëse din anglisht dhe për të dërguar email- dhe si të dërgohet “Landing page” dhe kjo punë paguhet mesatarisht mirë. Asnjëherë A apo S nuk më kanë kërkuar që të kryej ndonjë punë të kundërligjshme. Ka theksuar se punën që e ka bërë mund të kryhet nga shtëpia dhe e ka kryer me laptop të vetin dhe nuk është e domosdoshme të kesh një zyre, vetëm duhet qasja në internet dhe ska lidhje prej ku punon. Lidhur me 5000 email-at, ka shtuar se kur kam jam marrë në pyetje në ATK më kanë pyet për punën që e kam bërë në këtë kompani dhe përmes një usb iu kam dërguar 5000 email-at dhe ju kam treguar se kjo është puna që kam bërë në atë firmë faktikisht dhe për këto shërbime i ka marrë 500 euro.

3.2 Provat materiale

3.2.1 Nga leximi i raportit Policor Informues së bashku me shkresa tjera përcjellëse, me numër të referencës DHKEK-421/2020, me datën 04.11.2020 i Policisë e Kosovës, DHKEK-DPP Prishtinë, gjykata ka vërtetuar se në këtë raport janë konstatuar veprimet hetimore që ka ndërmarë oficeri-hetuesi E J, i cili me datën 03.11.2020 kishte pranuar një shkresë lidhur me të akuzuarin A K, pronar i subjektit juridik “Readleads Marketing”, i cili si subjekt në ATK kishte deklaruar qarkullimin në vlerë prej 201,000.00 Euro nga llogaria me numër e biznesit të tij si dhe veprimet tjera hetimore që janë përshkruar në këtë raport.

3.2.2 Nga leximi i Raportit Policor -mbi zbatimin e Urdhëresës së Gjykatës PPPS.nr...., 2021-KE-71, me shkresa të tjera përcjellëse të dhënat bankare nga 14 institucionet financiare dhe 6 CD-ja, me numër të referencës 2021-KE-71, lëshuar me datën 11.05.2021 nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë, gjykata ka vërtetuar se me datën 19.04.2021 urdhëresa numër PPPS.nr... të datës 15.04.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, është shpërndarë nëpër institucione financiare.

3.2.3 Nga leximi i faturës me numër 2019 04, e datës 30.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se subjekti juridik “Readleads Marketing” SH.P.K si shitës kishte faturuar-lëshuar faturën e lartpërmendur për blerësin - subjekti juridik “AV NETWORKS UG” në Gjermani, për Shërbime, me një përshkrim si “Email Shoot payout SOI, Emial Marketing”, në sasi prej 8500, për një çmim pa TVSH 10 Euro për copë, me çmimin total pa TVSH prej 85000 Euro, e cila faturë përmban dy vulat e bizneseve të lartpërmendura dhe nënshkrimet e dy pronave si e faturuar dhe pranuar nga këto dy biznese.

3.2.4 Nga leximi i faturës me numër 2019 05, e datës 30.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se subjekti juridik “Readleads Marketing” SH.P.K si shitës kishte faturuar-lëshuar faturën e lartpërmendur për blerësin - subjekti juridik “EB Media UG” në Gjermani, për Shërbime, me një përshkrim si “Email Shoot payout SOI, Emial Marketing”, në sasi prej 6000, për një çmim pa TVSH 10 Euro për copë, me çmimin total pa TVSH prej 60000 Euro, e cila faturë përmban dy vulat e bizneseve të lartpërmendura dhe nënshkrimet e dy pronave si e faturuar dhe pranuar nga këto dy biznese.

3.2.5 Nga leximi i faturës me numër 2019 06, e datës 30.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se subjekti juridik “Readleads Marketing” SH.P.K si shitës kishte faturuar-lëshuar faturën e lartpërmendur për blerësin - subjekti juridik “AV NETWORKS UG” në Gjermani, për Shërbime, me një përshkrim si “Email Shoot payout SOI, Emial Marketing”, në sasi prej 8000, për një çmim pa TVSH 10 Euro për copë, me çmimin total pa TVSH prej 80000 Euro, e cila faturë përmban dy vulat e bizneseve të lartpërmendura dhe nënshkrimet e dy pronave si e faturuar dhe pranuar nga këto dy biznese.

3.2.6 Nga leximi i faturës me numër 2019 07, e datës 30.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se subjekti juridik “Readleads Marketing” SH.P.K si shitës kishte faturuar-lëshuar faturën e lartpërmendur për blerësin - subjekti juridik “EB Media UG” në Gjermani, për Shërbime, me një përshkrim si “Email Shoot payout SOI, Emial Marketing”, në sasi prej 7500, për një çmim pa TVSH 10 Euro për copë, me çmimin total pa TVSH prej 75000 Euro, e cila faturë përmban dy

vulat e bizneseve të lartpërmendura dhe nënshkrimet e dy pronave si e faturuar dhe pranuar nga këto dy biznese.

3.2.7 Nga leximi i faturës me numër 2019 10, e datës 30.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se subjekti juridik “Readleads Marketing” SH.P.K si shitës kishte faturuar-lëshuar faturën e lartpërmendur për blerësin - subjekti juridik “AV NETWORKS UG” në Gjermani, për Shërbime, me një përshkrim si “Email Shoot payout SOI, Email Marketing”, në sasi prej 5500, për një çmim pa TVSH 10 €uro për copë, me çmimin total pa TVSH prej 55000 €uro, e cila faturë përmban dy vulat e bizneseve të lartpërmendura dhe nënshkrimet e dy pronave si e faturuar dhe pranuar nga këto dy biznese.

3.2.8 Nga leximi i Raportit Informues të ATK-së, Departamentit të Hetimeve Tatimore dhe Intelgjencës me numër të referencës /2021, i datës 29.10.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se ATK kishte bërë një hetim sa i përket biznesit “Redleads Marketing” Sh.P.K dhe më pas e kishte njoftuar PSRK se bazuar në deklaratimet e ATK-së për gjatë vitit 2019, tatim paguesi A K kishte deklaruar qarkullim në vlerë prej 705,000.00 euro bazuar edhe në faturat e lëshuara për shërbimet e kryera prej shumës 705,000.00 euro, ndërsa pagesat e pranuar në xhirollogaritë janë në vlerë prej 525,00.00 euro ku prej tyre janë ngrirë përkohësisht në vlerë prej 233,420.12 euro në NLB si dhe fatura në vlerë prej 180,000.00 euro të deklaruara pranë ATK-së nuk janë paguar ende nga bizneset “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, ndërsa obligimet tatimore pranë ATK-së në vlerë prej 70,449.40 euro bazuar në faturat e lëshuara nga biznesi “Readleads Marketing” SH.P.K. Bazuar në faturat në shërbimet e kryera nga biznesi “Readleads Marketing” SH.P.K për dy bizneset në Gjermani “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, tatimpaguesi “Readleads Marketing” SH.P.K nuk ka shmangie tatimore në provat – faturat, transaksionet bankare të cilat i kemi siguruar gjatë fazës së hetimeve për periudhën 2019 pranë ATK-së.

3.2.9 Nga leximi i shkresave të ATK-së me titull “Gjendja e përgjithshme e deklaratimeve dhe transaksioneve të tjera” për biznesin Redleads Marketing Sh.p.k, me numër fiskal ..., lëshuar me datën 24.05.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se në këto shkresa shihet dhe pasqyrohet gjendja e përgjithshme e deklaratimeve dhe transaksioneve të kompanisë “Readleads Marketing” SH.P.K, pranë ATK-së.

3.2.10 Nga leximi i Shkresës së ATK-së, me numër të listës 09/2021, lëshuar me datën 19.04.2021, nga ATK, Shkresa pasqyrë e të ardhurave personale A K me numër të letërnjoftimit ..., prej 2012-2021 dhe shkresat e tjera, gjykata ka vërtetuar se nga kjo shkresë e lëshuar nga

ATK shihet pasqyra e të ardhurave për A K n nga viti 2012 deri në vitin 2021, lista e pagave për kompaninë “Redleads Marketing”, aktivitetet nga qendra e thirrjeve, pasqyra e tatimpaguesit, pronari A K, gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera të kompanisë “Redleads Marketing”.

3.2.11 Nga leximi i Shkresës së ARBK-së, lidhur me “Redleads Marketing” SH.P.K, për A K, lëshuar me datën 14.04.2021, nga ARBK, gjykata ka vërtetuar se kompania “Redleads Marketing” është e regjistruar në ARBK me datë 25.07.2019 ku si drejtor ishte A K, me lloj të biznesit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar..

3.2.12 Nga leximi i Shkresës e ATK-së, Departamentit të Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, gjykata ka vërtetuar faktin se në këtë raport konstatohet: se nga inspektorët në zyret e DHTI-së ishte sjellë dëshmitari H G punëtor i tatimpaguesit “Redleads Marketing” SH.P.K i cili kishte deklaruar se është i punësuar në këtë biznes, i cili kishte sjell kontratën e punës që ka qenë i punësuar te kjo kompani dhe në formë elektronike kishte sjell email adresat me 500 email-a me të cilat është dëshmuar se si kishte punuar në këtë kompani.

3.2.13 Nga leximi i shkresave të ATK-së me titull “Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera” për biznesin Redleads Marketing Sh.p.k, me numër fiskal, lëshuar me datën 12.10.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se në këto shkresa shihet dhe pasqyrohet gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të kompanisë “Redleads Marketing” SH.P.K, për periudhën 2019-2021 pranë ATK-së.

3.2.14 Nga leximi i shkresës së NLB Banka “Qarkullimi për Llogari” e datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar qarkullimin e llogarisë bankare të kompanisë “Redleads Marketing” SH.P.K, përkatësisht shumat e debiteve dhe krediteve që ka pasur ky biznes në këtë llogari për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 20.04.2021.

3.2.15 Nga leximi i shkresës së NLB Banka “Qarkullimi për Llogari” e datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar qarkullimin e llogarisë bankare të akuzuarit A K, përkatësisht shumat e debiteve dhe krediteve që ka pasur i akuzuari në këtë llogari për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 20.04.2021.

3.2.16 Nga leximi i shkresës së Raiffeisen Bank, përkatësisht pasqyrës bankare të datës 24.04.2021, gjykata ka vërtetuar qarkullimin e llogarisë bankare të kompanisë “Redleads

Marketing” SH.P.K, përkatësisht shumat e debiteve dhe krediteve që ka pasur ky biznes në këtë llogari për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 24.04.2021.

3.2.17 Nga komunikimi elektronik-email-et, e datës 20.04.2021 dhe 27.04.2021 së bashku me shkresat tjera, gjykata ka vërtetuar se zyrtari në Menaxhimin e Urdhëresave në Bankën Ekonomike në Prishtinë hetuesit e rastit përmes emailit i kishte njoftuar se : “Readleads Marketing” SH.P.K, A K, V Sh dhe E B nuk ishin klient apo të autorizuar në këtë bankë, ndërsa S K kishte të hapur llogari personale mirëpo në këtë bankë nuk ishte si i autorizuar në ndonjë llogari dhe nuk kishte të autorizuar në llogarinë e tij personale, ndërsa udhëheqësi i ekipit të Departamentit të Hetimeve Tatimore D A kishte njoftuar hetuesit se për personin E B nuk kishin të dhëna përveq që është shtetas në Gjermani.

3.2.18 Nga leximi i Shënimeve Policore Zyrtare 3, 4, 5, të datave 09.11.2020, 02.12.2020 dhe datës 02.03.2021, si dhe shkresat përcjellëse, gjykata ka konstatuar se në këto raporte përshkruhen veprimet hetimore që kishte ndërmarrë zyrtari policor – rreshter E J, ku së bashku në këto urdhëresa janë bashkangjitur edhe shkresa tjera me të cilat ka vepruar, e në veçanti në shënimin zyrtar numër 4 shihet se kishte pranuar informata nga ILEC nga autoritetet Gjermane për personat V Sh dhe E B lidhur me veprimtarinë e tyre , përkatësisht të kompanive “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”.

3.2.19 Nga leximi i pasqyrës Financiare “Redleads Marketing” SH.P.K, i datës 31.12.2019, gjykata ka vërtetuar se në këto pasqyra financiare shihen pasuritë qarkulluese në këtë biznes të cilat janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë me datë 27.07.2020 dhe të njëjtat ishin nënshkruar nga A K, si drejtor ekzekutiv; F M V, si drejtor financiar; L K, si kontabilist i certifikuar.

3.2.20 Nga leximi i Statutit të biznesit “Readleads Marketing” SH.P.K të datës 24.07.2019, gjykata ka vërtetuar se ky biznes në përputhje me kërkesat nga neni 33 i Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë në Kosovë, themeluesit e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është nxjerrë statuti i Redleads Marketing si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si dhe ky biznes ishte i regjistruar në ARBK, në emër të pronarit A K.

3.2.21 Nga leximi i Raportit Informues Policor me Nr. reference DHKEK-..., me datën 04.11.2020, nga Policia e Kosovës, DHKEK-DPP Prishtinë, gjykata ka konstatuar se në këto

raporte përshkruhen veprimet hetimore që kishte ndërmarrë zyrtari policor – rreshter E J, ku së bashku në këto urdhëresa janë bashkangjitur edhe shkresa tjera me të cilat ka vepruar,

3.2.22 Nga leximi i shkresës së datës 01.08.2019 nga Policia e Kosovës, DHKEK -DPP Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se së bashku me këtë shkresë ishte bashkangjitur edhe kontrata e lidhur në gjuhën angleze me datë 01.08.2019, në mes të AV Networks UG në emër të V Sh dhe Redleads Marketing në emër të A Kt.

3.2.23 Nga leximi i komunikimit elektronik, emaili i datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se zyrtarja për ekzekutimin e pagesave në NLB Bankë i kishte njoftuar hetuesit policor se “Readleads Marketing” SH.P.K dhe A K kishin llogari pranë kësaj banke ku të njëjtëve iu kishin dërguar edhe gjendjen e llogarive bankare ndërsa sa i përket S K kishte llogari mirëpo nuk kishte qarkullim në llogari për periudhën e kërkuar. Ndërsa për personat V Sh dhe E B të njëjtit nuk kishin llogari të hapur në NLB Bankë.

3.2.24 Nga leximi i kërkesave të Departamentit të Hetimeve Tatimore dhe Intelegjencës nga ATK, të datave 20.04.2021 dhe 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar se nga zyrtarja e ATK-së - Inspektor hetues në DHT i është drejtuar të gjitha bankave Komerciale në Kosovë dhe Moneta Shpk, Vlesa Co, Capital Ria, UFP që për biznesin Redleads Marketing sh.p.k, S K, A K, V Sh dhe E B , të nxjerrën të gjitha pasqyrat e llogarive bankare personale, në emër të bizneseve për vitet 2019-2021, të dhënat për personat e autorizuar, të cilët kanë qasje në llogaritë, qoftë të biznesit apo personale dhe dëshmitë nëse personat e lartë cekur janë të autorizuar në ndonjë llogari tjetër bankare.

3.2.25 Nga leximi i përgjigjes së MONETA, me nr. ref. P-50/21, e datës 23.04.2021, gjykata ka vërtetuar se ishte përgjigjur ATK-së se nga të dhënat që ishin nxjerr nga MONETA Sh.P.K se personi S K kishte përdorur shërbime nga kjo kompani vetëm një herë duke pranuar para nga Amerika në total 102.91 euro. Ndërsa biznesi “Readleads Marketing” SH.P.K nuk e ka përdorur shërbimin e tyre.

3.2.26 Nga leximi i shkresës Capital, të datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar se në këtë institucion financiar nuk ka të gjetura në programin e transfereve ndërkombëtare për asnjërin nga personat e kërkuar , por ka të gjetura në programin e pagesave lidhur me 3 personat në fjalë gjatë periudhës kohore 01.01.2019-.21.04.2021, për S K, si e gjetur ishte se kishte bërë pagesë për regjistrimin e veturës, për letërnjoftim dhe patent shofer si dhe për sigurimin e veturës, për

A K ishte bërë pagesë për letërnjoftim dhe patent shofer dhe E B për pasqyrë të noterve, diplomë dhe disa shërbime tjera.

3.2.27 Nga leximi i komunikimeve elektronik, emailit të datave; 21.04.2021 dhe 20.04.2021, të zyrtares së Bankës Private për Biznes dhe zyrtarit në T.C Ziraat Bankasi A.S-Dega në Kosovë dhe zyrtarit të BKT-së, gjykata ka vërtetuar faktin se nga këto banka hetuesit policor ishin informuar se “Readleads Marketing” SH.P.K , S K, A K, V Sh dhe E B nuk kanë llogari të hapur në Bankën për Biznes si dhe lidhur me personin E B nuk ka të dhëna përveç se është shtetas Gjerman.

3.2.28 Nga leximi i shkresave të sjella nga ATK, nga T.C Ziraat Bankasi A.S-Dega në Kosovë, Banka për Biznes, ProCredit Bank, Moneta; Bankës Ekonomike dhe BKT-së, lidhur me të dhënat financiare të kërkuara për dëshmitarët në këtë rast H G dhe F M V, këto institucione i kishin njoftuar hetuesit e rastit se të njëjtit nuk kanë llogari dhe nuk janë klient të institucioneve të lartpërmendura.

3.2.29 Nga leximi i raportit Policor për zbatimin e autorizimit numër referencës: 589/22, PPS.nr.96/2020, të datës 20.06.2022, gjykata ka vërtetuar veprimet hetimore të oficerit Berat Gashi në të cilin raport konstatohet se: sektori për Hetimin e Krimeve Kibernetike gjatë hulumtimeve në burimet e hapura dhe rrjete sociale ka arrit të gjej disa të dhëna për dy bizneset të cilat janë të regjistruara në Gjermani, ndërsa për biznesin që është i regjistruar në Kosovë përveç të dhënave që gjenden në ARBK, nuk kanë mundur të gjejnë ndonjë informatë tjetër. Sa i përket biznesit “AV NETWORKS UG” konstatohet se është i regjistruar si biznes me datën 11.09.2015 në Gjermani në qytetin Schleswigs me një kapital prej 1000 euro dhe veprimtaria e këtij biznesi është kryesisht ofrimi i shërbimeve në fushën e marketingut dhe përvetësimin e klientëve për shërbimin në internet, ku si drejtor menaxhues i këtij biznesi është V Sh. Po ashtu sa i përket biznesit “EB Media UG” konstatohet se edhe ky biznes është i regjistruar në Gjermani me datën 05.03.2019, me një kapital prej 500 euro, edhe ky biznes mundëson ofrimin e shërbimeve në fushën e marketingut dhe përvetësimin e klientëve për shërbimin në internet, ku si drejtor menaxhues i këtij biznesi E B.

3.2.30 Nga leximi komunikimeve elektronike, email-ve, të datave: 12.10.2021, 14.10.2021, 11.02.2022 , 16.03.2022, 20.05.2022, 31.01.2022, 11.02.2022, shihen komunikimet që ka bërë prokurori i shtetit (i çështjes) me Departamentin për bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të

Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, për kërkesën për ndihmë juridike ndërkombëtare me Gjermanin.

3.2.31 Nga leximi i përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me nr. ref. MD/DBGJ/3057/fn/22, DBJN/2021-710, me datën 29.06.2022, Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar se Ministria e Drejtësisë ishte përgjigjur lidhur me kërkesën për ndihmë juridike ndërkombëtare të PSRK-së të kërkuar nga autoritet Gjermane lidhur me pandehurit V Sh dhe E B, për bizneset e tyre përkatësisht “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG” ashtu që Zyra Federale e Drejtësisë në Bon të Gjermanisë përmes shkresës së datës 22.06.2022 ishte përgjigjur kërkesës së PSRK për ndihmë juridike ashtu që zyra e policisë kriminale të shtetit Schleswigs në Kiel e kishte njoftuar lidhur me kërkesën për të pandehurit V Sh dhe E B dhe kompanitë e tyre të lartpërmendura me të dhënat gjenerale për veprimtarinë e këtyre bizneseve ku janë bashkangjitur edhe dokumentet tjera të cilat janë ndërmarrë gjatë procedurës për ndihmë juridike ndërkombëtare në Gjermani.

3.2.32 Nga leximi i kontratës së datës 01.08.2019, e lidhur në mes dy kompanive “AV Networks UG” dhe “Redleads Marketing”, në gjuhën angleze dhe përkthyer në gjuhën shqipe, gjykata ka vërtetuar faktin se në mes të biznesit “AV Networks UG” me seli në Gjermani, me pronar V Sh dhe “Redleads Marketing” me seli në Republikën e Kosovës, me pronar A K, ishte lidhur kontratë me datë 01.08.2019, ku kontraktuesit kishin përcaktuar edhe kushtet e kontratës dhe atë: për çështjet e përgjithshme, për tarifatat dhe kushtet e pagesës dhe shpenzimeve, kufizimeve në publikim, konfidencialitetit, afatit dhe zgjatjes e marrëveshjes, për të drejtat autoriale, për përfaqësimet dhe garancitë, për dëmshpërblimin dhe për kushtet tjera të përcaktuara sipas kontratës.

3.2.33 Nga leximi i kontratës së datës 01.08.2019, e lidhur në mes dy kompanive “EB Media UG” dhe “Redleads Marketing”, në gjuhën angleze dhe përkthyer në gjuhën shqipe, gjykata ka vërtetuar faktin se në mes të biznesit “EB Media UG” me seli në Gjermani, me pronar E B dhe “Redleads Marketing” me seli në Republikën e Kosovës, me pronar A K, ishte lidhur kontratë me datë 01.08.2019, ku kontraktuesit kishin përcaktuar edhe kushtet e kontratës dhe atë: për çështjet e përgjithshme, për tarifatat dhe kushtet e pagesës dhe shpenzimeve, kufizimeve në publikim, konfidencialitetit, afatit dhe zgjatjes e marrëveshjes, për të drejtat autoriale, për përfaqësimet dhe garancitë, për dëmshpërblimin dhe për kushtet tjera të përcaktuara sipas kontratës.

3.2.34 Nga leximi i faturës së lëshuar nga “AV Networks UG” e datës 30.08.2019 , gjykata ka vërtetuar se “AV NETWORKS UG” për shërbimet që kishte kryer “Readleads Marketing” SH.P.K kishte lëshuar faturën nr:.. të datës 30.08.2019, me përshkrimin email marketing, CPL, CPC, CPA dhe CPX, në shumën e përcaktuar si në faturë., e cila faturë ishte nënshkruar dhe vulosur nga të dy kompanitë e lartpërmendura.

3.2.35 Nga leximi i faturës së lëshuar nga “EB Media UG” e datës 30.08.2019 , gjykata ka vërtetuar se “EB Media UG” për shërbimet që kishte kryer “Readleads Marketing” SH.P.K kishte lëshuar faturën nr:.. të datës 30.08.2019 me përshkrimin email marketing, CPL, CPC, CPA dhe CPX, në shumën e përcaktuar si në faturë., e cila faturë ishte nënshkruar dhe vulosur nga të dy kompanitë e lartpërmendura.

3.2.36 Nga shikimi i CD-së me 5000 email-a, shihen emaile të dërguara kompanive të ndryshme nga “Readleads Marketing” SH.P.K.

3.2.37 Nga leximi i shkresës dëshmi nga kompania për konsulencë tatimore, Vista MBH, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo kompani e kishte informuar ish mbrojtësin e të akuzuarit avokatin Naser Sopjani: se faturat e datës 30.09.2019 në shumë prej 85,000.00 euro, e datës 30.11.2019 në shumë prej 90,000.00 euro dhe e datës 30.12.2019 në shumë prej 55,000.00 euro (gjithsejtë 230,000.00 euro për vitin 2019) janë të regjistruara e të deklaruara si shpenzime jashtë vendit në pasqyrat financiare të kompanisë “AV Networks UG” me pronar V Sh, në Gjermani.

3.2.38 Nga deklarata pajtueshmërisë për kompaninë “Redleads Marketing” e datës 27.07.2020 për pasqyrën financiare që përfundon me datën 31.12.2019, gjykata ka vërtetuar deklaratën e pajtueshmërisë lidhur me pasqyrat financiare se janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, dhe kjo deklaratë ishte nënshkruar nga A K, drejtor ekzekutiv dhe F M V, drejtor financiar.

4. Mbrojtja e të akuzuarit

7.7.1 I akuzuari A K gjatë shqyrtimit gjyqësor në fazën e mbrojtjes ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe në konsultë me mbrojtësin e tij av.Xhafer Tahiri, ka deklaruar se e shfrytëzon të drejtën që të mbrohet në heshtje në këtë fazë të procedurës.

5. Gjetjet e gjykatës (Vlerësimi dhe analizimi i provave)

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, ashtu që konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, gjeti se nuk është provuar se i akuzuari A K ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si fakte të pakontestueshëm kanë qenë se i akuzuari A K kishte hapur biznesin e tij “Redleads Marketing” SH.P.K, me datën 25.07.2019, i cili biznes ishte regjistruar pranë ARBK-së, si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ku si drejtor ishte këtu i akuzuari A K, kjo vërtetohet nga shkresa e ARBK-së e datës 14.04.2021.

Nga statuti i nxjerrë nga “Redleads Marketing” SH.P.K, me datën 24.07.2019 vërtetohet si veprimtari të kësaj shoqërie-biznesi ishin agjencitë për publicitet, aktivitetet e specializuara të dizajnit dhe aktivitetet e fotografimit. Ky biznes përveç të akuzuarit si drejtor kishte të punësuar edhe dy punëtor dhe atë dëshmitaren F M V si kontabiliste e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se : *“në këtë kompani ka punuar nga dhjetori i vitit 2019 deri në përfundim të aktiviteti të kësaj kompanie që si datë e përfundimit nuk i kujtohet dhe që ishte paguar me një pagë mujore prej 300 euro dhe si detyrë e saj në këtë biznes ishte mbajtja e kontabilitetit, përgatitja e librave të shitjes dhe deklarimeve në ATK në këtë biznes”*. Po ashtu në këtë biznes ishte i punësuar edhe dëshmitari H G i cili kishte punuar kryesisht me gjenerimin e leads-ve dhe atë për të treguar se si bëhen emaillet dhe si dërgohen, i cili në këtë kompani kishte punuar për një periudhë të shkurtër kohore dhe për punën që kishte marrë pagën prej 500 euro.

Fakt tjetër i pakontestueshëm ka qenë se biznesi i të akuzuarit kishte të hapura dy llogari bankare, në bankat që funksionojnë në Republikën e Kosovës dhe atë në NLB dhe Raiffeisen Bank, ku të ardhurat, transferet dhe shpenzimet për këtë biznes i kishte bërë përmes llogarive të hapura në këto banka. Po ashtu i akuzuari kishte llogari bankare personale në emër të tij në NLB Bank, e të gjitha këto vërtetohen nga pasqyrat financiare-transaksionet të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor.

Po ashtu ka qenë si fakt i pakontestueshëm se subjekti juridik “Redleads Marketing” SH.P.K, ku për secilin shërbim kishte lëshuar faturë dhe atë kishte lëshuar edhe faturat: 2019 04, të datës 30.09.2019, 2019 05, të datës 30.10.2019, 2019 06, të datës 30.10.2019, 2019 07 , të datës 30.11.2019 dhe 2019 10, të datës 30.12.2019 ku në të gjitha këto fatura ishin lëshuar për shërbimet me titull email shoot payout SOI, email marketing, ku në secilën faturë ishte

përcaktuar sasia e shërbimit dhe çmimi për shërbim dhe çmimi total i shërbimeve dhe po ashtu për secilën faturë ishte shënuar blerësi i shërbimit që kryesisht në këto fatura kanë qenë kompanitë “AV Networks UG” dhe “EB Media UG” dhe këto vërtetohen nga faturat e lartpërmendura të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor.

Po ashtu për të gjitha shërbimet që kishte kryer i akuzuari si drejtor në subjektin juridik “Redleads Marketing” SH.P.K, i kishte bërë edhe deklaratimet pranë ATK dhe kjo vërtetohet nga vet raporti informues i ATK-së i datës 29.10.2021, për të cilën shihet se ATK kishte bërë një hetim lidhur me deklaratimet tatimore dhe në këtë raport konstatohet se: *“ATK kishte bërë një hetim sa i përket biznesit “Redleads Marketing”SH.P.K dhe më pas e kishte njoftuar PSRK se bazuar në deklaratimet e ATK-së për gjatë vitit 2019. Tatim paguesi A K kishte deklaruar qarkullim në vlerë prej 705,000.00 euro bazuar edhe në faturat e lëshuara për shërbimet e kryera prej shumës 705,000.00 euro, ndërsa pagesat e pranuar në xhirollogaritë janë në vlerë prej 525,00.00 euro ku prej tyre janë ngrirë përkohësisht në vlerë prej 233,420.12 euro në NLB si dhe fatura në vlerë prej 180,000.00 euro të deklaruara pranë ATK-së nuk janë paguar ende nga bizneset “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, ndërsa obligimet tatimore pranë ATK-së në vlerë prej 70,449.40 euro bazuar në faturat e lëshuara nga biznesi “Readleads Marketing” SH.P.K. Bazuar në faturat në shërbimet e kryera nga biznesi “Readleads Marketing” SH.P.K për dy bizneset në Gjermani “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, tatimpaguesi “Readleads Marketing” SH.P.K nuk ka shmangie tatimore në provat – faturat, transaksionet bankare të cilat i kemi siguruar gjatë fazës së hetimeve për periudhën 2019 pranë ATK-së.*

Sipas aktakuzës përkatësisht veprimeve inkriminuese të përshkruara në dispozitivin e saj , i akuzuari ngarkohet se: **“...nga data 25.07.2019 deri me datë 13.04.2021, përmes krijimit të faturave të rreme kishte realizuar të hyra të paligjshme, ndërsa me datë 02.11.2020, në bankën NLB në Prishtinë, kishte shkuar për të tërhequr në para të gatshme (cash) shumën e mjeteve në vlerë prej 201,000.00 euro (dyqind e një mijë euro), nga llogaria me numër 1701017400176665, në emër të biznesit të tij “ Redleads Marketing” SH.P.K, duke e ditur se këto mjete janë gjeneruar nga aktiviteti fiktiv ekonomik, me qëllim që të fsheh ose maskoj natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore...”**, e për të cilat veprime është dhënë kualifikimi ligjor se ka kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga nenin 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Në nenin 56 par.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, janë përcaktuar elementet inkriminuese të kësaj vepre penale në të cilën përcaktohen se: ***Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale.*** Nën paragrafi 1.5 i paragrafit 1 të nenit 56 të këtij ligji përcakton se: ***“fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla”***, ndërsa par.3 nënpar.3.1 përcakton: *“personi mund të dënohet për vepër penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për vepër të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerr pasuria e fituar me anë të veprës penale”*.

Ndërsa në nenin 2 par.1, të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit përcaktohen përkufizimet e këtij ligji dhe atë në nënpar.1.3 është përcaktuar përkufizimi i aktivitetit kriminal në të cilin përcaktohet se: *“aktivitet kriminal është çdo lloj përfshirje kriminale në kryerjen veprës penale siç përcaktohet në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës”*

Në rastin konkret prokuroria pretendon se të ardhurat përkatësisht pasuria e të akuzuarit buron **nga aktiviteti kriminal dhe në aktakuzë ka përdorë shprehjen se “nga aktiviteti fiktiv ekonomik”**. Pra sipas këtij përkufizimit ligjor për të ekzistuar kjo vepër penale me aktivitet kriminal, duhet që i akuzuari të ketë ditur ose kishte arsye për të ditur se pasuria të jetë e ndërlidhur dhe buron nga një formë e aktivitet kriminal (pra nga njëra nga format kishte për dijeni se: *pasuria është e ndërlidhur nga vepra penale.*

Fillimisht gjykata do të bëj një analizë lidhur me pretendimin e PSRK-së, përkatësisht veprimin e përshkruara në aktakuzë se *“i akuzuari përmes krijimit të faturave të rreme kishte realizuar të hyra të paligjshme...”*.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari kishte krijuar fatura të rreme dhe kishte realizuar të hyra të paligjshme, për shkak se

biznesi “Redleads Marketing” SH.P.K, ku si drejtor ishte këtu i akuzuari A K, kishte kryer shërbime të marketingut online, për shërbimet e kryera biznesi “Redleads Marketing” SH.P.K kishte lëshuar fatura të cilat ishin të ligjshme, ngase i njëjti të gjithash shërbimet e kryera dhe faturat i kishte deklaruar në ATK dhe vet ky organ përkatësisht ATK gjatë hetimit tatimor nuk kishte konstatuar ndonjë parregullsi qoftë për nga ana e deklarimeve të tij tatimore, shërbimeve të kryera apo përmbajtjes së faturave të cilat kanë mundur të jenë si jo të rregullta sipas ligjit apo të rreme, prandaj pretendimi i PSRK se i akuzuari kishte krijuar fatura të rreme është i pabazuar ngase me asnjë provë nuk ka vërtetuar parregullsinë apo kundërligjshmërinë e faturave.

Po ashtu nuk është vërtetuar se i akuzuari kishte realizuar nga të hyra të paligjshme për shkak se nga provat gjykata ka vërtetuar se njëjti kishte realizuar të hyra me biznesin e tij “Redleads Marketing” SH.P.K, si rezultat i shërbimeve kryera të marketingut online (në internet) sipas kontratave që kishte me dy kompanitë me seli në Gjermani “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, pra për shërbime të marketingut. Këto fakte fillimisht vërtetohen nga vet raporti informues i ATK-së i datës 29.10.2021, në cilin konstatohet se: *“tatim paguesi A K kishte deklaruar qarkullim në vlerë prej 705,000.00 euro bazuar edhe në faturat e lëshuara për shërbimet e kryera prej shumës 705,000.00 euro, ndërsa pagesat e pranuar në xhirollogaritë janë në vlerë prej 525,00.00 euro ku prej tyre janë ngrirë për kohësisht në vlerë prej 233,420.12 euro në NLB si dhe fatura në vlerë prej 180,000.00 euro të deklaruar pranë ATK-së nuk janë paguar ende nga bizneset “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, ndërsa obligimet tatimore pranë ATK-së në vlerë prej 70,449.40 euro bazuar në faturat e lëshuara nga biznesi “Redleads Marketing” SH.P.K. Bazuar në faturat në shërbimet e kryera nga biznesi “Redleads Marketing” SH.P.K për dy bizneset në Gjermani “AV NETWORKS UG” dhe “EB Media UG”, tatimpaguesi “Redleads Marketing” SH.P.K nuk ka shmangie tatimore në provat – faturat, transaksionet bankare të cilat i kemi siguruar gjatë fazës së hetimeve për periudhën 2019 pranë ATK-së”*. Pra siç shihet nga ky raport i ATK-së, ky organ kishte bërë një hetim tatimore në biznesin “Redleads Marketing” SH.P.K, kishte konstatuar se ky biznes i kishte bërë të gjitha deklaratimet në ATK lidhur me shërbimet e kryera, pra për periudhën kohore për të cilën ngarkohet i akuzuari me aktakuzë, pra vet ATK nuk kishte gjetur shmangie tatimore, nuk kishte konstatuar se faturat ishin të rreme apo që transaksionet ishin jo të rregullta që i kishte ky biznes gjatë veprimtarisë së tij për këtë periudhë kohore, mirëpo saktësisht kishte përcaktuar shërbimet, faturat e lëshura dhe të ardhurat nga janë realizuar si dhe detyrimet e mbretur. Pra, nga kjo vërtetohet se i akuzuari me biznesin e tij, iu kishte kryer shërbime dy kompanive “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, të cilat veprimtarinë e tyre e kishin në Gjermani dhe kishte lëshuar

faturat për dy kompanitë e lartcekura, ku përmes llogarisë bankare kishe pranuar edhe pagesat prandaj vërtetohet se i njëjti kishte realizuar të hyra të ligjshme.

Edhe nga faturat 2019 04, të datës 30.09.2019, 2019 05, të datës 30.10.2019, 2019 06, të datës 30.10.2019, 2019 07, të datës 30.11.2019 dhe 2019 10, të datës 30.12.2019 është vërtetuar se të gjitha këto fatura ishin lëshuar nga biznesi Redleads Marketing” SH.P.K, dhe të njëjtat ishin lëshuar me përshkrimin me titull “email shoot payout SOI, email marketing”, ku në secilën faturë ishte përcaktuar sasia e shërbimit, çmimi për shërbim dhe çmimi total i shërbimeve dhe po ashtu për secilën faturë ishte shënuar blerësi i shërbimit që kryesisht në këto fatura kanë qenë të lëshuara për kompanitë “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, prandaj nuk është vërtetuar me asnjë provë se ku qëndron parregullsia e tyre qoftë në aspektin ligjore apo të ndonjë mënyre tjetër, pra nuk është vërtetuar se pse janë të rreme, kur vet ATK kishte konstatuar se faturat ishin lëshuar për shërbimet e kryera nga ky biznes për çka kishte pranuar pagesat përmes xhirollogarisë bankare.

Provat e lartpërmendura janë në harmoni edhe me deklarimin e dëshmitares F M V, e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“Faturat dhe përshkrimi i shërbimit kanë qenë në gjuhën angleze.... Përshkrimin e faturave psh. “me emërtimin email shoot payout SOI”...Më tej ka theksuar se në momentin që faturohet puna, fatura e periudhës që i përket, faturohet në librin e shitjes dhe libri i shitjes deklarohet që i përket në sistemin e rrjetit të ATK-së dhe nuk më ka ndodhur asnjëherë që të ketë refuzim ose kontakt prej ATK-së që nuk është diçka në rregull. Ka sqaruar se sa i përket faturave 2019-04 dhe fatura 2019-05 nuk ka pasur ndonjë parregullsi dhe asnjëra prej faturave nuk më janë kthyer nga ATK.*

Po ashtu edhe nga pasqyrat e deklaruara tatimore dhe pasqyrat e xhirollogarive bankare të “Redleads Marketing” SH.P.K, vërtetohet se të hyrat përkatësisht pagesat ishin pranuar nga “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, si rezultat i shërbimeve të kryera nga i akuzuari A K me biznesin e tij “Redleads Marketing” SH.P.K, me për të cilat shërbime i akuzuari kishte lidhur kontrata të ligjshme me dy kompanitë e lartpërmendura, ku si objekt kishin marketingun online në internet.

Pra nga provat e lartpërmendura nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë se i akuzuari kishte krijuar fatura të rreme dhe përmes tyre kishe realizuar hyra të paligjshme, ngase nga të lartpërmendurat vërtetohet se i akuzuari me biznesin e tij “Redleads Marketing” SH.P.K kishte kryer shërbime të marketingut online (në internet) dhe për të gjitha shërbimet e kryera si subjekt juridik kishte

lëshuar fatura të ligjshme, në të cilat ishte shënuar shërbimi i kryer, sasia e shërbimit të kryer, çmimi për sasi dhe çmimi në total dhe blerësin, të cilat shërbime i kishte deklaruar në ATK dhe po ashtu përmes xhirollogarisë së tij bankare, kishte pranuar pagesat nga bizneset në Gjermani, përkatësisht “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, pra me asnjë provë nuk është vërtetuar se faturat ishin të rreme dhe se të hyrat ishin të paligjshme, por që të hyrat-mjetet ishin si rezultat i shërbimit të kryer për çka kishte pranuar edhe pagesat e rregullta.

Në vazhdim gjykata do të bëjë një analizë lidhur me pretendimin tjetër të PSRK-së, përkatësisht veprimin e përshkruara në aktakuzë se “*i akuzuari duke e ditur se këto mjete janë gjeneruar nga aktiviteti fiktiv ekonomik, me qëllim që të fsheh ose maskoj natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore...*” pra në rastin konkret siç është theksuar edhe më parë prokuroria pretendon se të ardhurat përkatësisht pasuria e të akuzuarit buron nga aktiviteti kriminal dhe në aktakuzë ka përdorë shprehjen se “*nga aktiviteti fiktiv ekonomik*”.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka ardhur në përfundim se ky pretendim është i pabazuar, për shkak se nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale për të cilin ngarkohet i akuzuari, ngase elementet e kësaj vepre penale konsumohen kur të ardhurat janë nga vepra penale – (që nënkupton që çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale. Pra, pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale e cila përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose përzier çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale).

Në rastin konkret PSRK pretendon se pasuria – parat janë gjeneruar nga “aktivitetit fiktiv ekonomik”, mirëpo nuk ka përcaktuar se aktiviteti fiktiv ekonomik a ndërlidhet me ndonjë vepër penale për të cilën është dyshuar apo dënuar ndonjë person tjetër po dhe vet i akuzuari, pra nuk e ka përcaktua aktivitetin kriminal në mënyrë të çartë për shkak se ka përdorë shprehjen “aktivitetit fiktiv ekonomik” mirëpo nuk ka treguar se cili është “aktivitet fiktiv ekonomik” pra pasuria a buron nga vepra e ndërlidhur penale e cila është e dënueshme edhe sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës apo ndonjë Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës ashtu siç kërkon neni neni 2 par.1 nënpar.1.3 i Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Prandaj edhe pse PSRK nuk përcaktuar në

mënyrë saktë e cila ka qenë ai aktivitet fiktiv ekonomik nga të cilat janë gjeneruar mjetet, me qëllim që të fsheh ose maskoj natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore..., mirëpo gjykata në vazhdim do të elaboroj faktin se pasuria – të ardhurat a kanë rrjedhë – a janë gjeneruar nga aktiviteti fiktiv ekonomik si term i përgjithshëm ashtu siç pretendohet PSRK.

Siç është theksuar edhe me lartë i akuzuari A K kishte hapur biznesin e tij “Redleads Marketing” SH.P.K, me datën 25.07.2019, i cili biznes ishte regjistruar pranë ARBK-së, si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe si veprimtari i këtij biznesi ishte se vepronte si agjenci për publicitet, aktivitete të specializuara të dizajnit dhe aktivitetet e fotografimit. Këto fakte vërtetohen nga shkresa e ARBK-së e datës 14.04.2021 dhe statuti i nxjerrë nga “Redleads Marketing” SH.P.K, me datën 24.07.2019.

Po ashtu i akuzuari si drejtor me Biznesin e tij “Redleads Marketing” SH.P.K, kishte lidhur dy kontrata dhe atë me biznesin “AV Networks UG” me seli në Gjermani, me pronar V Sh dhe biznesin “EB Media UG” me seli në Gjermani, me pronar E B, ashtu që kishte kryer shërbime të marketingut në internet (online) sipas kontratave për këto dy kompani dhe po ashtu për të gjitha shërbimet kishte lëshuar fatura të rregullta, e të cilat shërbime të gjitha i kishte deklaruar në ATK.

Nga provat që janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari A K, për shërbimet e marketingut në internet (online) sipas kontratave me këto dy kompani kishte pranuar transaksione ligjshme nga kompanitë “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, kompani të ligjshme në Gjermani sipas faturave të lëshuara nga “Red Leads Marketing” SH.P.K për shërbimet e kryera, pra i akuzuari për shërbimet e kryera në biznesin e tij kishte lëshuar fatura për secilin shërbim të kryer dhe për këto shërbime ishte paguar nga bizneset “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, që të dyja biznese me seli në Gjermani dhe të gjitha pagesat ishin bërë përmes xhirollogarisë bankare të këtyre bizneseve.

Pra, në rastin konkret dihet burimi dhe prejardhja e pasurisë, pra buron nga llogaritë bankare përkatësisht të ardhurat janë gjeneuar nga AV Networks UG” dhe “EB Media UG” si kompani të ligjshme në shtetin e Gjermanisë, pra këto ishin pagesat për shërbime të kryera “Redleads Marketing” SH.P.K, pra në rasti konkret nuk kemi të bëjmë me transaksione të fshehta financiare, as me mjete financiare për të cilat nuk i dihet burimi i tyre, sepse në rastin konkret

vetëm dihet se burimi i mjeteve financiare të cilat janë qarkulluar në llogarinë e biznesit të “Redleads Marketing” SH.P.K, dhe po ashtu mjeteve të sekuestruara, ishin pagesa për shërbimet e marketingut online që kishte kryer kjo kompani për dy kompanitë gjermane të cilat edhe kishin bërë pagesë për këto shërbime.

Se kompanitë AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, ishin kompani të ligjshme vërtetohet nga përgjigja e datës 29.06.2022 nga Ministria e Drejtësisë e cila nga Zyra Federale e Drejtësisë në Bon të Gjermanisë, përmes Ndhmës Juridike Ndërkombëtare e kishte njoftuar PSRK-në, për veprimtarinë e këtyre dy kompanive pra AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, se këto kompani ofronin shërbime të pavarura shkencore teknike në lidhje me agjencinë e reklamave edhe marrëdhëniet me publikun dhe shërbime të ngjashme dhe agjencive reklamuese dhe se këto kompani paguajnë tatim në Gjermani dhe kanë veprimtari tërësisht të ligjshme biznesore.

Në këtë drejtim vlen të theksohet fakti se në këtë rast PSRK me të marrë këtë provë, kishte marrë aktvendimin për pushimin e pjeshëm të hetimeve me numër PPS.nr 96/20 të datës 25.08.2022, me të cilin kishte pushuar pjesërisht hetimet ndaj të pandehurve; S K, V Sh dhe E B, shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga nenin 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 dhe 57 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

PSRK në arsyetimin e këtij aktvendimi vet PSRK kishte theksuar se; *“në veprimet e pandehurve S K, V Sh dhe E B nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se të njëjtit kanë kryer veprën penale... sepse në këtë çështje penale dyshimet e ngritura për deponimet e të dhënave financiare janë sqaruar pas dhënies së marrjeve të dokumenteve të dy bizneseve nga “AV Networks UG” dhe “EB Media UG”, me seli në Gjermani, si dhe të konfirmuara se janë në mënyrë të rregullt me të gjitha procedurat e bizneseve të pandehurve V Sh dhe E B të cilët paguajnë tatimin në Gjermani si dhe arsyetimi i vet deklaratave të tyre është qartë se raportet përfundimtare për secilin vit paraprak janë të rregullta andaj, duke gjetur se në rastin konkret nuk ka elemente të veprës penale që ju vihet në barrë e as elementet e ndonjë vepre tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare është pushuar hetimi ndaj të pandehurve të lartpërmendur... ”.*

Prandaj në rastin konkret pretendimi i prokurorisë është tejet kontradiktor për shkak se fillimisht me aktvendimin e lartpërmendur kishte pushuar hetimin ndaj të pandehurve të lartpërmendur dhe kishte ngritur aktakuzë vetëm ndaj të akuzuarit A K me pretendimin se paratë janë gjeneruar nga aktiviteti fiktiv ekonomik, e që në rastin konkret nga të lartpërmendurat nuk është vërtetuar se ku qëndron aktiviteti fiktiv ekonomik kur është vërtetuar se kemi pasur të bëjmë me raporte

kontraktuale midis bizneseve për shërbime të marketingut online, e që i akuzuari me kompaninë e tij “Red Leads Marketing SHPK”, kishte kryer shërbime të marketingut online dhe kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit H G i cili ka deklaruar se kishte bërë punë për këtë kompani dhe përmes USB, ATK-së ia kishte dërguar 5000 e-maila për të iu treguar për punën që kishte bërë në këtë biznes për shërbimet të kryera, e për të cilat shërbime dy kompanitë gjermane “AV Networks UG dhe EB Media UG”, kishin bërë edhe pagesat si detyrime ndaj “Red Leads Marketing SHPK”, përmes xhironlogarive bankare të atyre kompanive në llogarinë bankare të kompanisë “Red Leads Marketing SHPK”.

Ky fakt vërtetohet edhe nga shkresa si dëshmi nga kompania për konsulence tatimore Visa MBH në Gjermani, e cila e kishte njoftuar mbrojtësin e të akuzuarit se faturat e datës 30.09.2019 në shumë prej 85,000.00 euro, e datës 30.11.2019 në shumë prej 90,000.00 euro dhe e datës 30.12.2019 në shumë prej 55,000.00 euro (gjithsejtë 230,000.00 euro për vitin 2019) janë të regjistruara e të deklaruara si shpenzime jashtë vendit në pasqyrat financiare të kompanisë “AV Networks UG” me pronar V S, në Gjermani.

Prandaj, gjykata nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor një nga një, e pastaj të ndërlidhura njëra me tjetrën, mori aktgjykim lirues për faktin se aktakuza ka mbetur në nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo të bazuar mirë në prova të artikulueshme dhe të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, andaj në mungesë të provave të akuzuarin A K e ka liruar nga akuza për veprën penale Shpërlarja e parave nga nenin 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin dhe pastrimin të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

5.Pretendimet e prokurorisë në fjalën përfundimtare

Përveç pretendimeve të PSRK-së, që janë elaboruar më lartë me rastin e vlerësimit të provave, prokurori në fjalën përfundimtare ka dhënë edhe pretendime tjera si në vijim:

Sipas pretendimeve të PSRK-së: *“i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshme të dobisë pasurore kishte përpiluar dokumente me përmbajtje të rreme apo me prezantim tjetër të rrem, kishte prezantuar qarkullimin e rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë ka rezultuar me krijimin e fondeve që në shikim të parë duken të ligjshme krejt kjo me qëllim të fshehjes apo maskimit të vërtetë të burimit të këtyre parave ku të njëjtat janë siguruar përmes*

krijimit të faturave fiktive kinse në emër të shërbimit të marketingut edhe pse të akuzuarit i mungojnë shkathtësitë dhe njohuritë bazike në këtë fushë. Po ashtu pretendimi i prokurorisë ishte se paratë janë siguruar me mashtrim, sepse nuk ka mundësi që të njëjtat të jenë të siguruar në mënyrë të ligjshme e kësaj i shtohet fakti se i akuzuari nuk ka njohuri si udhëhiqet një afarizëm ekonomik e aq me pak në fushën e teknologjisë informative dhe nuk ka mundësi që i njëjti paratë në fjalë të ketë siguruar nga klientët e tij në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë afariste”. Këto pretendime sipas vlerësimit të gjykatës janë të pabazuara për shkak se fillimisht sa i përket pretendimit se kishte krijuar fatura të rreme apo me prezantim të rremë për të prezantuar qarkullimin e rezultateve të veprimtarisë ekonomike, gjykata në lidhje me këto pretendime ka dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt në pjesën e gjetjeve të gjykatës, me të cilin ka vërtetuar se i akuzuari nuk kishte krijuar fatura të rreme, qarkullimi i mjeteve (parave) ishte i ligjshëm ishe bërë për shkak të shërbimeve të kryera si biznes dhe nuk ka mundur të vërtetojë se kishte elemente të mashtrimit apo prezantimit të rremë apo që kishte për qëllim fshehjen ose maskimin e mjeteve, ngase të gjitha transaksionet për shërbime të kryera i akuzuari i kishte pranuar në xhirollogarinë bankare nga dy kompani legjitime të cilat e ushtronin të njëjtin veprimtari në shtetin e Gjermanisë.

Ndërsa sa i përket pretendimit të prokurorisë e cila shpërfaq mëdyshje në aspektin personal të njohurive të akuzuarit rreth shkathtësive të tij në ushtrimin e funksionit të veprimtarisë së biznesit, po ashtu ky pretendim është i pabazuar për shkak se këto pretendime dhe mëdyshje nuk i bazon në prova konkrete dhe kryesisht janë deklarative për shkak se siç është elaboruar edhe më lartë, i akuzuari në biznesin e tij “Redleads Marketing SHPK”, kishte të punësuar dy punëtorë H G dhe F M V, ashtu që dëshmitari H G, ishte marrë me pjesën e teknologjisë informative, ndërsa dëshmitarja F M V ishte marrë me çështjen e kontabilitetit. Prandaj gjykata vlerëson se mëdyshjet lidhur me faktet vendimtare nuk mund të interpretohen në dëm të të akuzuarit, për shkak se kjo është në kundërshtim edhe me parimin *In Dubio Pro Reo* nën 3 par.2 të KPP-së në të cilin është përcaktuar se: “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

6. Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në nenin 363, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP-së, gjykata e liroi nga akuza të akuzuarin A K, për kryerjen e veprës penale siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7. Vendimi mbi kthimin e sendeve

Gjykata duke u bazuar në nenin 113 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarit A K, ti kthehet shuma e mjeteve të cilat ishin ndaluar sipas urdhri ndalues afatgjatë për ngrirjen e përkohshme të asetëve, me numër PPPS.41/2020 i datës 03.12.2020, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që ka vendosur që të shfuqizojë urdhrin e lartpërmendur dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ka urdhëruar NLB Bank Prishtinë, që ti heq të gjitha ndalesat të cilat janë urdhëruar sipas urdhrit të lartpërmendur në këtë llogari bankare, për shkak se gjykata nuk e ka vërtetuar faktin se të njëjtat kanë qenë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale apo të cilat janë përdorur me kryerjen e veprës penale, prandaj është bërë kthimi për shkak se nuk ka pasur bazë për konfiskimin e tyre.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në nenin 453 të KPP-së gjykata ka vendosur që shpenzimet të bien në barrë të mjeteve buxhetore, për shkak se i akuzuari është liruar nga akuza.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- DEPARTAMENTI SPECIAL -

PS.nr.36/22, me datë 15.03.2023

**Bashkëpunëtorja profesionale,
Dafina Ymeri**

**Kryetari i trupit gjykues,
Mentor Bajraktari**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.